

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-344/021	Data: Datum: 30.06.2021	

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13. dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010 dhe Rregullores për Ndarjen Bursave për Studentë Nr.49/2017), shqyrtoj kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim për kompensimin e studentëve të cilët janë përfitues të bursave për vijimin e studimeve dhe propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** Kërkesa e Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensimin e 75 bursave për student, për periudhën tetor 2020/shtator 2021.
- Kompensohen 38 bursist të ri nga fondi burimor 21 nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim në shumë të mjeteve financiare prej 22,800.00€ dhe 37 bursist që janë vazhdim nga viti i kaluar kompensohen nga fondi burimor 21 nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim në shumë të mjeteve financiare prej 22,440.00€.
- Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do t'iu transferohen në xhirollogaritë e studentëve përfitues të bursave nga Drejtoria për Arsim, në pajtim më me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- Shuma e mjeteve financiare për shpërndarjen e bursave për periudhën tetor 2020/shtator 2021 është 45,240.00€.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim-Zyrtari Financiar.
- Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendim njoftohet: Drejtoria për Arsim, Zyrtari Financiar dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-343/21	Data: Datum: 30.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), shqyrtojë kërkesën 08-Nr.124/2021 të datës 23.06.2021 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për caktimin e kriterëve për realizimin e projektit “Furnizim me material ndërtimor për raste emergjente”, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 08-Nr.124/2021 e datës 23.06.2021 e parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për caktimin e kriterëve për realizimin e projektit “Furnizim me material ndërtimor për raste emergjente”, për përkrahje të rasteve emergjente duhet të plotësohet njëri kriter si me poshtë:

- 1.1. Rastet sociale (Kartoni i socialit);
- 1.2. Veteran i luftës (Libreza e veteranit të luftës ;
- 1.3. Invalidë i luftës-parashtruesi i kërkesës apo anëtarët e familjes (Libreza e invalidit të luftës);
- 1.4. Rast pa punë (Vërtetimi që është i pa punë nga Agjencia e Punësimit);
- 1.5. Rastet e dëmtuara nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore (Procesverbal nga Komisioni i komunës dhe foto nga vendi i ngjarjes);
- 1.6. Rastet me gjendje të vështirë ekonomike (Komisioni verifikon rastin në vendin e ngjarjes për gjendjen e rënd ekonomike dhe harton procesverbal);
- 1.7. Rastet që nuk kanë strehim, janë përfitues nga donatorët, nga të afërmit, kanë mbledhë mjete për ndërtimin e shtëpisë por kanë nevojë për përkrahje shtesë (dëshmi për këto raste).

2. Komisioni ka për obligim që ti zbatoj kriteret e lartcekura gjatë shqyrtimit të kërkesave për përkrahje të rasteve emergjente; të hartoj procesverbal për këto raste; të njoftoj Kryetarin e Komunës listën e përfituesve si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim obligohet të ketë dëshmi për plotësimin e njërit nga kriteret e cekura me lartë për çdo kërkesë e cila përkrahet

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendim njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje e vendimit mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-342/021	Data: Datum: 29.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, shqyrtoj kërkesën Nr.01-553-15636 të datës 06.05.2021 të parashtruar nga Agim Maxharraj nga fsh. Vrellë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa Nr.01-553-15636 e datës 06.05.2021 e parashtruar nga Agim Maxharraj për përkrahje financiare për nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit dhe i ndahen 100.00€ (njëqind euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Agim Maxharraj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendim është përfundimtar.

A r s y e t i m

Agim Maxharraj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-553-15636 të datës 06.05.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit për anëtarët e familjes.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtin e konsideron te arsyeshme dhe e miraton.

I lartpërmenduri është në gjendje të rend ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ti nxjerr dokumentet e identifikimit për familjen e tij dhe për këtë arsye përkrahet me 100.00€ (njëqind euro).

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit njoftohen: Agim Maxharraj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-341/021	Data: Datum: 29.06.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën Nr.01-400-14103 të datës 22.04.2021 të parashtruar nga Daut Elshani nga fsh. Staradran për rindërtimin e lapidarit dhe formon komisionin për vlerësimin e investimeve në lapidarin e dëshmorëve në fsh. Staradran, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHEN: Komisioni për vlerësimin e investimeve në lapidarin e dëshmorëve në fsh. Staradran dhe në Komision caktohen:

1. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Kryesues i Komisionit;
2. **Genc Ademaj**, Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Projekteve për partneritet publiko-privat, anëtar; dhe
3. **Dukagjin Hoxhaj**, Zyrtar për Regjistrimin e Adresave, anëtar.

2. Komisioni i cekur më lartë ka për obligim që të dalë në vendin e ngjarjes dhe të bëjë vlerësimin e investimeve për rindërtimin e lapidarit; të hartojnë procesverbalin dhe të njoftojnë Kryetarin e Komunës me koston e mjeteve financiare për rindërtimin e lapidarit si dhe do t'i kryej punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Komisioni duhet të ja filloj punës menjëherë si dhe e merr përgjegjësin për vlerësimin e investimeve në lapidarin e dëshmorëve.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendim do të njoftohen: **Komisioni**, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-340/2021	Data: Datum: 28.06.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Mirëmbajta e adresave” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-3805-1-3-6 dhe numer të brendshëm prokurimi 633-021-028-136, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Mirëmbajta e adresave” me numër jashtëm prokurimi 633-021-3805-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-028-136 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Rustem Gashi,** Inxh. i Arkitekturës-Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Bushat Gashi,** Zyrtar për Kadastër, anëtar dhe
- 1.3. Hasan Kajtazaj,** Zyrtar për Hipoteka anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit për projektin: “Mirëmbajta e adresave” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis .

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-339/2021	Data: Datum: 28.06.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog”, Lot2 “ Ndërtimi i ndriçimit publik në Cërrcë”, Lot3 “Ndërtimi i ndriçimit publik në Tomoc “, Lot4 “Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugët vëllezërit Zeqiraj, Esat Morina dhe 10 dhjetori”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-3483-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-024-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog”, Lot2 “ Ndërtimi i ndriçimit publik në Cërrcë”, Lot3 “Ndërtimi i ndriçimit publik në Tomoc “, Lot4 “Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugët vëllezërit Zeqiraj, Esat Morina dhe 10 dhjetori”, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-3483-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-024-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar dhe
- 1.3. Dukagjin Hoxhaj**, Inxh. i komunikacionit-Zyrtar për Regjistrim të Adresave, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektet: Lot1 “Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog”, Lot2 “ Ndërtimi i ndriçimit publik në Cërrcë”, Lot3 “Ndërtimi i ndriçimit në Tomoc “, Lot4 “Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugët vëllezërit Zeqiraj, Esat Morina dhe 10 dhjetori” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA
[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-338/2021	Data: Datum: 28.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-2903, të datës 25.01.2021, e parashtruar nga z.Hivzi Imeraj, nga Istogu, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-2903, të datës 25.01.2021, e parashtruar nga z.Hivzi Imeraj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Hivzi Imeraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Hivzi Imeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-2903, të datës 29.01.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Hivzi Imeraj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim. Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Hivzi Imeraj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen: z.Hivzi Imeraj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-335/2021	Data: Datum: 25.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektet: Lot1 “Betonimi i kanalit të ujitjes në Dubovë”, Lot2 “Betonimi i kanalit të ujitjes termal Onix-Carrallukë”, Lot3 “Betonimi i kanalit Dobrushë-Lubovë, Lot4 “Rregullimi i përroit vërshues në Kaliqan nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: Menaxher i kontratës, **Dukagjin Hoxhaj**, Zyrtar për Regjistrimin e Adresave dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës **Lulzim Shoshi**, Drejtor i DBPH për projektet: Lot1 “Betonimi i kanalit të ujitjes në Dubovë”, Lot2 “Betonimi i kanalit të ujitjes termal Onix-Carrallukë”, Lot3 “Betonimi i kanalit Dobrushë-Lubovë, Lot4 “Rregullimi i përroit vërshues në Kaliqan me numër të jashtëm prokurimi 633-021-1265-521 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-021-009-521, të cilat projekte i ka fituar për ti realizuar grupi i operatorëve ekonomik “LURN” SH.P.K “ENGINEERING GROUP” SH.P.K.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.


3. Përgjegjësin për realizimin e projekteve të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: **Dukagjin Hoxhaj, Lulzim Shoshi**, Grupi i Operatorëve Ekonomik “LURN” SH.P.K “ENGINEERING GROUP” SH.P.K dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Zyrtari Kryesor Administrativ
z.Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-334/021	Data: Datum: 25.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën: Nr.01-400-21213, të datës 10.06.2021; të parashtruar nga Ibrahim Mulaj nga Istogu përfaqësues i OJQ "ABA", për përkrahje me karburant për nevojat OJQ-së, e cila organizon një aktivitet me moton edhe unë dua ta di dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHEN:** kërkesën Nr.01-400-21213 e datës 10.06.2021 e parashtruar nga Ibrahim Mulaj për përkrahje me karburant për nevoja të "OJQ-ABA" e cila organizon një aktivitet me moton edhe unë dua ta di, aktivitetit do të realizohet 7ditë në Republikën e Shqipërisë, dhe përkrahet me 400 litra karburant.
2. Obligohet Zyrtari i Transportit, përfaqësuesin Ibrahim Mulaj "OJQ-ABA" të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ibrahim Mulaj, ka parashtruar kërkesën Nr.01-400-21213, të datës 10.06.2021, për përkrahje me karburant për nevoja të "OJQ-ABA", e cila organizon një aktivitet me moton edhe unë dua ta di, aktivitetit do të jetë 7ditë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën Ibrahim Mulaj dhe të njëjtat i konsideron të arsyeshme dhe i miraton. Duke parë rendësin e punës së OJQ "ABA" që realizon aktivitete të ndryshme me femrat ne zonat rurale dhe realizimin e aktivitetit me moton edhe unë dua ta di i cili do të realizohet 7 ditë në Republikën e Shqipërisë dhe përkrahet me 400 litra karburant për realizimin e këtij aktiviteti. Zyrtari i Transportit do ti pajisë me vërtetim për furnizim me karburante të lartpërmendurit nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Shefi i Autoparkut kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimi njoftohen: Ibrahim Mulaj, Zyrtari i Transportit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 Zekije SUTAJ





Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-333/021	Data: Datum: 25.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-50/2021 të datës 22.06.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa me Nr.02-49/2021 të datës 22.06.2021 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, për intervistimin me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin **Zyrtar/e i/e Lartë Ligjor** të publikuar me datën 27.05.2021 në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe KVLBK formohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. Hatixhe Arifaj,** Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Fatmir Bytyçi,** Menaxher i Personelit, anëtar;
- 1.3. Naser Gjocaj,** Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar;
- 1.4. Arlinda Kurtaj,** Udhëheqëse e Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, anëtare;
- 1.5. Rasim Mahmutović,** Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar.

2. KVLBK zëvendësues është në këtë përbërje si me poshtë:

- 2.1. Jehona Arifaj,** Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime me Qytetar, Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. Agim Haxhiu,** Drejtor i Qendrës Kulturore, anëtar;
- 2.3. Haki Ibrahimaj,** Drejtorë i Qendrës për Punë Sociale, anëtar;
- 2.4. Muhamet Gusturanaj,** Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian, anëtar;
- 2.5. Abedin Neziraj,** Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitete, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: KVLBK, Komisioni Zëvendësues, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-332/021	Data: Datum: 25.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-49/2021 të datës 22.06.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa me Nr.02-49/2021 të datës 22.06.2021 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, për intervistimin me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin **Zyrtar/e i/e Lartë për Tatimin në Pronë** të publikuar me datën 27.05.2021 në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe KVLBK formohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. **Hatixhe Arifaj**, Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. **Fatmir Bytyçi**, Menaxher i Personelit i anëtar;
- 1.3. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar;
- 1.4. **Zizë Bujupi**, Udhëheqëse e Sektorit për Arsim, anëtare dhe
- 1.5. **Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar.

2. KVLBK zëvendësues është në këtë përbërje si me poshtë:

- 2.1. **Jehona Arifaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime me Qytetar, Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. **Agim Haxhiu**, Drejtor i Qendrës Kulturore, anëtar;
- 2.3. **Haki Ibrahimaj**, Drejtorë i Qendrës për Punë Sociale, anëtar;
- 2.4. **Muhamet Gusturanaj**, Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian, anëtar;
- 2.5. **Abedin Neziraj**, Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitete, anëtar.


3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: KVLBK, Komisioni Zëvendësues, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ




Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-331/021	Data: Datum: 25.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrat e Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-48/2021 të datës 22.06.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa me Nr.02-48/2021 të datës 22.06.2021 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, për intervistimin me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin **Zyrtar/e i/e për Barazi Gjimore** të publikuar me datën 27.05.2021 në Drejtorinë për Administratë dhe KVLBK formohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. **Arlinda Kurtaj**, Udhëheqëse e Sektorit Administrative, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. **Fatmir Bytyçi**, Menaxher i Personelit i anëtar;
- 1.3. **Haki Ibrahimaj**, Drejtorë i Qendrës për punë sociale, anëtar;
- 1.4. **Muhamet Gusturanaj**, Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian., anëtar dhe
- 1.5. **Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar.

2. KVLBK zëvendësues është në këtë përbërje si me poshtë:

- 2.1. **Jehona Arifaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime me Qytetar, Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. **Agim Haxhiu**, Drejtor i Qendrës Kulturore, anëtar;
- 2.3. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar;
- 2.4. **Rexhep Blakaj**, Udhëheqës i Sektorit të Urbanizimit anëtar;
- 2.5. **Enisa Corovic**, Zyrtare për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitetit, anëtare.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrat e Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni- KVLBK, Komisioni Zëvendësues, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-330/021	Data: Datum: 25.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në bazë të nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe bazuar në Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-47/2021 të datës 22.06.2021 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa me Nr.02-47/2021 të datës 22.06.2021 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për formimin e Komisionit të vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, për intervistimin me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin Zyrtar/e i/e Lartë për Personel të publikuar me datën 27.05.2021 në Zyrën e Kryetarit dhe KVLBK formohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. **Fatmir Bytyçi**, Menaxher i Personelit, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. **Hatixhe Arifaj**, Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, anëtare;
- 1.3. **Muhamet Gusturanaj**, Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian, anëtar;
- 1.4. **Zizë Bujupi**, Udhëheqëse e Sektorit për Arsime, anëtare dhe
- 1.5. **Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar.

2. KVLBK zëvendësues është në këtë përbërje si me poshtë:

- 2.1. **Jehona Arifaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime me Qytetar, Kryesuese e Komisionit;
- 2.2. **Agim Haxhiu**, Drejtor i Qendrës Kulturore, anëtar;
- 2.3. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar;
- 2.4. **Sami Metaj**, Zyrtar i Lartë Ligjor, anëtar;
- 2.5. **Abedin Neziraj**, Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitete, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevojat të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset Komisioni.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni KVLBK-, Komisioni Zëvendësues, Menaxheri i Personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-329/2021	Data: Datum: 25.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-5804, të datës 11.02.2021, e parashtruar nga z.Sinan Maraj, nga fsh.Vrellë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-5804, të datës 11.02.2021, e parashtruar nga z.Sinan Maraj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150€(njëqindë e pesëdhjetë euro), nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Sinan Maraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Sinan Maraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-5804, të datës 11.02.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Sinan Maraj, është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për përdorim të terapisë mjekësore, të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjetet nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Sinan Maraj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të këtij Vendimit të njoftohen z.Sinan Maraj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-327/2021	Data: Datum: 24.06.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit për formimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektin: “Ndërtimi i teshatoreve ne stadiumin e futbollit Demush Mavraj-Istog-faza e dytë” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2922-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-022-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektin: “Ndërtimi i teshatoreve ne stadiumin e futbollit Demush Mavraj-Istog-faza e dytë” me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2922-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-022-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Dukagjin Hoxhaj,** Inxh. i komunikacionit-Zyrtar për Regjistrim të Adresave, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Blerim Bujupi,** Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
- 1.3. Qefser Ibrahimaj,** Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit, anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit për projektin: “Ndërtimi i teshatoreve ne stadiumin e Futbollit Demush Mavraj-Istog-faza e dytë” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartëcekur e merr Komisioni.

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-323/021	Data: Datum: 23.06.2021	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësimin e dëmit i Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi, shqyrtoi kërkesën Nr.09-320-37541 të datës 01.12.2020 të parashtruar nga Ajdin Salihaj nga fsh.Shushicë, Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga era dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-37541 e datës 01.12.2020 e parashtruar nga Ajdin Salihaj, për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga era që i ka demtuar kulmin e stallës së lopëve dhe i ndahen **158.00€ (njëqind e pesëdhjetë e tetë euro)** nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transvere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Ajdin Salihaj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ajdin Salihaj, ka parashtruar kërkesën Nr.09-320-37541 të datës 01.12.2020, me të cilën ka kërkuar t'i ndahet mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga era që i ka demtuar kulmin e stallës së lopëve.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga era dhe të njëjtin e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka vlerësuar dëmin e fermerit të shkaktuar nga era dhe bazuar në mundësit buxhetore që posedon DBPH propozon të përkrahet fermeri në shumë prej ndahen **158.00€ (njëqind e pesëdhjetë e tetë euro)**.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike nuk ka të ardhura dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ta ndertojë kulmin e stallës së lopëve.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: **Ajdin Salihaj**, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-320/021	Data: Datum: 22.06.2021	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Sanimi i dëmeve dhe izolimi komplet i kulmit të palestrës sportive” ne Istog me numër të jashtëm prokurimi 633-20-1203-5-2-1/ C337 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-011-521 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: “Sanimi i dëmeve dhe izolimi komplet i kulmit të palestrës sportive” ne Istog me numër të jashtëm prokurimi 633-20-1203-5-2-1/ C337 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-020-011-521: të cilin e ka realizuar në vitin 2020 **operatori “B.I”**, të cilin e përfaqëson z. Halit S Rama, nga Komuna e Prishtinës, dhe në komision caktohen:

- 1.1. **Qefsere Ibrahimaj**, Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturore dhe Arkiv të Qytetit, Kryesuese e Komisionit,
- 1.2. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar dhe;
- 1.3. **Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj mbikëqyrësin e punimeve, do të njoftoj Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartëcekur; do të hartojë procesverbalin për verifikimin e punimeve si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Vendimi është perfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: **Komisioni, Prokurimi, operatori “B.I”**, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-319/2021	Data: Datum: 22.06.2021	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-22384, të datës 18.06.2021, të parashtruar nga c, nga fsh.Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes se tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-22384, të datës 18.06.2021 e parashtruar nga z.Muhamet Maraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(Radioterapisë) dhe i lejohen 100 litra karburant.
